



Kalendari i aktiviteteve për Javën e Parasë

17-23 mars 2025

Java e Parasë është një festë mbarëbotërore e parasë, e cila ka për qëllim ndërgjegjësimin e brezit të ri për të qenë qytetarë të ardhshëm të përgjegjshëm dhe të aftë për të marrë vendime financiare të mirëmenduara. Banka e Shqipërisë, në bashkëpunim me Shoqatën Shqiptare të Bankave dhe mbështetjen e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, si shumë institucione të tjera në mbarë globin organizojnë aktivitete të larmishme për t'i përfshirë fëmijët dhe të rinjtë, duke u mësuar si të kujdesen për paratë, si të kursejnë, si të mendojnë financiarisht apo si t'i kuptojnë ndryshimet në sistemet ekonomike ku jetojnë, si të fitojnë të ardhura nëpërmjet sipërmarrjes dhe të vendosin bazat për të ardhmen e tyre nëpërmjet kulturës financiare.

Organizatorë:

Banka e Shqipërisë (BSH) dhe Shoqata Shqiptare e Bankave (AAB), me mbështetjen e: Ministrisë së Arsimit dhe Sportit (MAS), Agjencisë së Sigurimit të Depozitave (ASD), Bankës Botërore (BE), Junior Achievement of Albania (JAA).

Tema e këtij viti: “Ndiq me mençuri, begati në ardhmëri! - 100 vjet bankë qendrore në Shqipëri!”

E hënë, 17 mars 2025

Ora 11:00, Tiranë

Ceremonia e çeljes së Javës së Parasë organizohet në ambientet e Muzeut të Bankës së Shqipërisë. Guvernatori i Bankës së Shqipërisë dhe Kryetari i Shoqatës Shqiptare të Bankave në fjalët e tyre të shkurtra përshëndetëse theksojnë ndër të tjera misionin e Javës së Parasë dhe promovojnë rëndësinë e kulturës financiare për publikun e gjerë dhe në veçanti për brezat e rinj.

Aktiviteti vijon me shpërndarjen e çmimeve për fituesit e 5 konkurseve të prezantuara një muaj më parë nga BSH dhe AAB:

1. **Konkursi për nxënësit e klasave III “Vizato kartëmonedhën tënde”**, me temë: "100 vjet Banka e Shqipërisë, banka jonë qendrore" – 10 fitues
2. **Konkursi për klasat IV me projekte mbi temën “100 vjet Banka e Shqipërisë, banka jonë qendrore!”** – 5 fitues
3. **Konkursi për nxënësit e klasave VIII me fotomontazhe (meme) “Ndiq me mençuri, begati në ardhmëri! - 100 vjet bankë qendrore në Shqipëri!”** – 5 fitues
4. **Konkursi për nxënësit e shkollave të mesme “Videoja më e mirë”** me temë “Ndiq me mençuri, begati në ardhmëri!” – 5 fitues



5. **Konkursi i esesë më të mirë me temë “100 vjet Banka Qendrore në Shqipëri: Rruga drejt stabilitetit dhe zhvillimit ekonomik” – 3 fitues**

Ora 11:30, Tiranë

Trajnim për Kompanitë e Shkollave të Mesme të Tiranës me temë “Shkrimi i raportit”, me 35-40 nxënës të shkollave të arsimit të mesëm, organizuar nga Junior Achievement of Albania.

E martë, 18 mars 2025

Ora 10:00, Tiranë

Leksion i hapur në Western Balkan University nga: Shoqata Shqiptare e Bankave dhe Komiteti i Sigurisë Kibernetike.

Ora 11:30, Tiranë

Trajnim për Kompanitë e Shkollës “Sami Frashëri” Tiranë, me temë “Design Thinking”, me 35-40 nxënës të shkollës “Sami Frashëri”, organizuar nga Junior Achievement of Albania.

Ora 11:30, Tiranë

Leksion i hapur në EPOKA University nga: Shoqata Shqiptare e Bankave dhe Komiteti i Sigurisë Kibernetike.

E mërkurë, 19 mars 2025

Ora 10:00, Tiranë

Leksion i hapur në Canadian Institute of Technology (CIT) nga: zj. Xhilda Shehu, Intesa SanPaolo Bank mbi pagesat, kartat dhe digjitalizimin (AAB).

Ora 10:30, Tiranë

Workshop për punonjëset femra të kompanisë "HAKO" me temë "Edukimi financiar për gratë në punë: Menaxhimi i parasë dhe qasja në shërbimet bankare" (AAB).

Ora 11:00, Vlorë

Leksion i hapur në Universitetin “Ismail Qemali” të Vlorës, me temë "Politika Monetare, Stabiliteti financiar dhe kërkimi ekonomik: Njohuri nga Banka e Shqipërisë", nga Meri Papavangjeli, Departamenti i Kërkimeve, BSH.



Ora 11:00, Elbasan

Leksion i hapur në Universitetin "Aleksandër Xhuvani" të Elbasanit, me temë "100 vjet numizmatikë", nga Bujana Sokoli, Departamenti i Kërkimeve (BSH), dhe Teuta Toska, pedagoge në departamentin e gjuhësisë të Fakultetit të Shkencave Humane në Universitetin "Aleksandër Xhuvani", Elbasan (BSH).

Ora 12:30, Tiranë

Debati studentor me temë "Albania goes Cashless - Pros and Cons", me studentë të Universitetit të Tiranës, organizuar nga Banka e Shqipërisë në bashkëpunim me Bankën Botërore. Aktiviteti do të përshëndetet nga përfaqësuesi i Bankës Botërore, z. Richard Record; Dekani i FEUT, z. Bernard Dosti; dhe Zëvendësguvernatorja e Parë e Bankës së Shqipërisë, zj. Luljeta Minxhozi (BSH, BB).

E enjte, 20 mars 2025

Ora 9:30, Tiranë

Forum Biznesi "E ardhmja është tani: si po riformëson inovacioni, shërbimet financiare shqiptare në 2025?", organizuar nga Banka e Shqipërisë në bashkëpunim me Dhomën Amerikane të Tregtisë (BSH dhe Dhoma Amerikane e Tregtisë).

Ora 10:00, Tiranë

Leksion i hapur në Universitetin Evropian të Tiranës nga: zj. Odeta Paloka, ABI Bank mbi pagesat, kartat dhe digjitalizimin (AAB).

Ora 11:30, Tiranë

Leksion i hapur në Universitetin e Tiranës, Fakulteti Ekonomik nga: zj. Elona Labinoti, FIB Bank mbi pagesat, kartat dhe digjitalizimin (AAB).

Ora 11:30, Tiranë

Trade Game – Alumni, me 40 nxënës, organizuar në kuadër të Javës Globale të Parasë, nga Junior Achievement of Albania (JAA).

E premte, 21 mars 2025

Ora 10:00, Korçë

Leksion i hapur në Universitetin "Fan S. Noli", Korçë, me temë "Bankat qendrore dhe roli i tyre në epokën digjitale", nga **Prof. Dr. Luljeta Minxhozi**, Zëvendësguvernatore e Parë, Banka e Shqipërisë (BSH).



Ora 10:00, Tiranë

Leksion i hapur në Tirana Business University dedikuar historikut të sistemeve dhe instrumenteve të pagesave dhe inovacionet aktuale, nga Edlira Hoxha, Departamenti i Sistemeve të Pagesave, Kontabilitetit dhe Financës (BSH).

Ora 10:30, Shkodër

Leksion i hapur në Universitetin "Luigj Gurakuqi", Shkodër, me temë "100 vjet Banka e Shqipërisë: Nga historiku te sfida e kohëve moderne në epokën digjitale dhe ndryshimeve klimatike", nga Dr. Margerita Topalli, Departamenti i Kërkimeve, Banka e Shqipërisë (BSH).

Ora 12:00, Tiranë

Leksion i hapur në University of New York Tirana nga: zj. Jonida Kaçani, Departamenti i Mbikëqyrjes, Banka e Shqipërisë, dhe zj. Irida Huta, OTP Bank mbi *open banking*, pagesat, kartat dhe digjitalizimin (BSH dhe AAB).

AKTIVITETE JASHTË DATEVE TË JAVËS SË PARASË

E mërkurë, 26 mars 2025 (TBC)

Ora 9:30, Tiranë

Leksion i hapur në Universitetin Bujqësor Tiranë, me temë "Bankat qendrore dhe roli i tyre në epokën digjitale", nga **Prof. Dr. Luljeta Minxhozi**, Zëvendësguvernatore e Parë, Banka e Shqipërisë (BSH).

E enjte, 10 prill 2025

Ora 11:00, online

Kuizi Evropian i Parasë (European Money Quiz), një konkurs mbarevropian me qëllim përmirësimin e kulturës financiare të fëmijëve të moshës 13 - 15 vjeç. Klasat e 9-ta do të konkurrojnë drejtpërdrejt me njëra-tjetrën gjatë një aktiviteti "live", në platformën Kahoot!. Skuadrat do të duhet t'u përgjigjen saktë dhe shpejt pyetjeve të konkursit kombëtar. Çdo klasë do të përfaqësohet me nga disa skuadra me nga 2 nxënës. Në fazën e dytë, dy nxënësit fitues kombëtarë do të përfaqësojnë Shqipërinë në finalen evropiane të Kuizit, në Bruksel.